



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 02.10.2019, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Niko Peleshi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”. (*Komision përgjegjës*)

Marrin pjesë:

Niko Peleshi, Halil Jakimi, Besnik Baraj, Gjetan Gjetani, Rrahman Rraja, Andrea Marto, Tatiana Nurçe, Ilir Ndraxhi, Arben Pëllumbi, Robert Bitri, Dritan Bici, Halil Jakimi, Nimet Musaj, Zef Shtjefni, Kujtim Gjuzi, Halit Valteri, Fadil Nasufi dhe Ilirjan Pendavinji.

Mungojnë:

Lefter Koka, Ilir Beqaj, Ardit Konomi, Arlind Çaçani dhe Egllantina Gjermani.

Të ftuar:

Ilir Bejtja – Zëvendësministër i Infrastrukturës dhe Energjisë

Mehmet Hasalami – Drejtor në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Enea Karakaçi – Drejtor në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Adhurim Çausi – Përfaqësues i Shoqatës së Minierave të Shqipërisë

HAPET MBLEDHJA

Niko Peleshi – Mirëdita!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Veprimtaritë Prodhuese. Në rendin e ditës kemi projektligjin “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10304, datë 15.7.2010 “Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”. Relator është zoti Andrea Marto. Ky projektligj është parashikuar për në seancë në datën 17 tetor. Ne jemi komisioni përgjegjës.

Kemi të ftuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë: zëvendësministrin, zotin Ilir Bejtja, zotin Mehmet Hasalami, drejtor, zotin Enea Karakaçi, drejtor, si dhe nga Shoqata e Minierave të Shqipërisë, zotin Adhurim Çausi. Shoqata ka paraqitur propozimin për një ndryshim, por që do ta diskutojmë gjatë shqyrtimit të ligjit.

Po i jap fjalën relatorit, zotit Andrea Marto për një prezantim të ligjit. Më pas fjalën e ka zoti Bejtja.

Andrea Marto - Faleminderit, zoti kryetar!

Ndryshimet që propozon ky projektligj paraqiten në kuadër të reformës së derregulimit, e cila synon redukimin e barrierave administrative, liberalizimin e tregut dhe përmirësimin e mëtejshëm të klimës së biznesit.

Në këtë kuadër, projektligji propozon shfuqizimin e licencës “Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me burimet minerare”. Me shfuqizimin e kësaj licence, ushtrimi i veprimtarisë së shërbimeve të ekspertizës dhe/ose profesionale lidhur me burimet minerare do të jetë i lirë dhe do të kryhet vetëm nga subjektet fizike të certifikuara për këtë qëllim, të cilat e kanë të regjistruar këtë objekt veprimtarie në regjistrin tregtar ose nga persona juridikë, të cilët kanë të punësuar individë të certifikuar.

Duke parë të gjithë procesin është vlerësuar se licencimi i subjektit juridik në këtë rast është një dokumentacion formal, që shton një hallkë të tepërt licencimi, pasi edhe pse sipas përcaktimeve të ligjit është personi juridik ai që pajiset me licencë, në fakt studimi kryhet nga personi fizik i licencuar. Mendoj se propozimi duhet të miratohet nga komisioni, sepse lehtëson procedurat për kompanitë e shfrytëzimit mineral.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Po, zoti Bejtja.

Ilir Bejtja – Përshëndetje!

Do të flasë zoti Hasalami.

Mehmet Hasalami - Në kuadër të reformës së derrugulimit, me qëllim krijimin e lehtësirave për subjektet që ushtrojnë aktivitete në fushën e studimit, të projektimit në sektorin gjeologo-minerar ose në industrinë minerare dhe me nismat e qeverisë në drejtim të këtij lehtësimi janë bërë disa rregullime të domosdoshme që ne kemi menduar se do të përmirësojnë rigorozisht procesin e projektimit dhe të studimit në fushën gjeologo-minerare, duke u dhënë mundësinë të gjithë operatorëve juridikë dhe fizikë për të ushtruar aktivitete në këtë industri. Duhet të theksojmë se rritja e informalitetit në këtë fushë e kërkon si domosdoshmëri edhe këtë lloj lehtësimi, në mënyrë që të aktivizohen shumica e potencialeve intelektuale, inxhinierike në këtë fushë.

Duhet të theksojmë se edhe në fushën minerare deri tani janë bërë projekte të ndryshme si në fushën e kërkim- zbulimit ashtu edhe në atë të shfrytëzimit të mineraleve, por realisht pothuajse ndjehet edhe mungesa e kuadrit ligjor në këtë fushë. Besoj se edhe ky ndryshim në ligj do t'i shërbejë në një mënyrë edhe arritjes dhe përmirësimit të cilësisë së këtyre projekteve në këtë fushë. Ne mendojmë se edhe në ligjin ekzistues ka qenë specifikuar mënyra sesi licencohet, si projektohet në këtë fushë, por këtu janë lehtësuar pak procedurat që lidhen me këto projekte.

Niko Peleshi - Ka pyetje?

Po, zoti Baraj. Më pas fjalën e ka zoti Marto.

Besnik Baraj - Faleminderit!

Në nenin 2, pika 2 thuhet: “Certifikohen për kryerjen e veprimtarive studimore e projektuese në fushën minerare personat që kanë aftësi teknike dhe përvojën e nevojshme për kryerjen e këtyre veprimtarive”. Më duket pak subjektive nëse nuk i referohet ndonjë rregulloreje apo kriteri të përcaktuar më qartë në lidhje me mundësinë që u jepet këtyre personave.

Një gjë tjetër që dua të komentoj, duke mbështetur dhe zotin Hasalami, që këto ndryshime aktivizojnë, afrojnë intelektualë, njerëz profesionistë, të cilët duhet ta japin kontributin e tyre. Në kuadrin e universitetit njësi të tilla si departamentet, që mund ta luajnë fare mirë këtë rol nëpërmjet stafeve që i kanë besoj, janë elitare në fushat përkatëse në Shqipëri, si mund ta marrin këtë rol? Nëse në një departament, njerëzit që punojnë aty e japin këtë lloj kontributi, duhet të vijnë individualisht të certifikohen, apo ju t'ua njihni automatikisht këtë statut të tyre nëse ata japin vlerësime, bëjnë oponenca e të tjera? Unë do ta quaja shumë pozitive nëse ne certifikojmë institucionin, njësinë, që padyshim janë më

kualitativët sot në Shqipëri. Në këto rrethana edhe ekipet që punojnë në këto njësi ta kenë këtë të drejtë për të dhënë këtë lloj kontributi, asistence dhe ekspertize.

Niko Peleshi - Të bëjmë njëherë pyetjet dhe pastaj të marrim përgjigjet.

Po, zoti Marto.

Andrea Marto – Nga projektligji, nuk del e qartë se cili është institucioni, struktura që do të kryejë procedurën e verifikimit dhe vlerësimit të përmbushjes së kërkesave për certifikim, sipas VKM-së përkatëse, të paraqitura nga subjektet. Cili është autoriteti që do të lëshojë certifikatën përkatëse?

Niko Peleshi – Po, zoti Gjuzi.

Kujtim Gjuzi – Po të shikohet me kujdes këtu thuhet se në përfundim të analizës me gjitha ato që ka bërë ministria 23 licenca eliminohen dhe nuk ka ndonjë sqarim. Jam i interesuar për licencat që eliminohen, si eliminohen, pasi kanë detyrime tek tatimet.

Niko Peleshi – Ka pyetje të tjera?

Mehmet Hasalami - Lidhur me pyetet e zotit Baraj, duhet të sqarojmë se procedura e licencimit të të gjitha stafeve, qoftë akademike, apo stafet inxhinierike që punojnë në fushën e minierave, të gjeologjisë, edhe të pasurimit automatikisht me vendim të qeverisë janë parashikuar kushtet dhe procedurat shumë specifike me anë të të cilave licencohen personat fizikë dhe subjektet juridike. Për projekte të rëndësisë së veçantë në këtë fushë edhe stafet akademike të universiteteve merren për oponencë teknike. Njëkohësisht, referuar vendimit të qeverisë që rregullon të gjitha kërkesat dhe kushtet për licencim edhe vetjak, edhe si person fizik, automatikisht pedagogët dhe stafet akademike kanë të drejtë të certifikohen, të marrin licencë, pra nuk përjashtohen, por mjafton që të kenë punuar, ose të punojnë në fushën e industrisë minerare. Ka shumë lehtësira, sepse është përcaktuar se mund të marrë edhe si person juridik, por edhe si person fizik, si pedagog i veçantë, mund të bëjnë studime në këto fusha pa asnjë lloj problemi. Vendimi i qeverisë në mënyrë taksative ka përcaktuar kushtet dhe kriteret me anë të të cilave licencohen këta akademike apo specialistë të kësaj fushe, nuk është përjashtuar asnjë. Fatmirësisht ministria jonë ka një marrëdhënie të shkëlqyer me Fakultetin e Gjeologji-Minierave dhe ne e kemi përdorur dhe vazhdojmë ta përdorim si konsulent të vazhdueshëm në problemet e rëndësishme të industrisë minerale. Pra mënyrën e licencimit e ka të përcaktuar vendimi i qeverisë, e ka të përcaktuar në mënyrë taksative.

Pyetja e zotit Marto është e drejtë, por përgjigjja i jepet në pikën 3 ku është përcaktuar se Këshilli i Ministrave me propozim të ministrit përgjegjës për veprimtarinë

minerare miraton vendimin e qeverisë për procedurat dhe kriteret për licencimin e subjekteve qofshin juridike, qofshin fizike. Pra, në pikën 3 e ka përcaktuar saktësisht, e ka adresuar: “Ministrisë përgjegjëse për Industrinë Minerare”. Besoj se edhe ky shqetësim është i zgjidhur.

Besnik Baraj - Vendimi ri, kjo masë që po merrni ju, ky vendim ligjor, sigurisht zhbën atë të mëparshmin. Janë adresuar ato lehtësira që thatë ju edhe në formatin e ri?

Mehmet Hasalami - Me miratimin e këtij projektligji ne kemi gati draftin në përputhje të plotë pothuajse me detyrimet që përcakton ligji, për ta kaluar në Këshillin e Ministrave në përputhje dhe në mbështetje të këtij ndryshimi, duke lehtësuar edhe procedurat e licencimit. Pra, e kemi përcaktuar edhe vijueshmërinë se si do të jetë pastaj afati...

Ilir Bejtja - Kam një sqarim të shkurtër. Duhet t’ju kujtojmë se ky është projektligji i katërt që vjen nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për këtë qëllim. Më përpara ka qenë edhe ligji “Për sektorin e gazit natyror”, i cili ka pasur të njëjtin parashikim për heqjen e marrjes së licencës, por mjaftonte vetëm certifikimi, edhe projektligji “Për auto-riparimet dhe serviset”, kishte të njëjtin qëllim. Ministria tashmë këtë e ka fushë të shtruar dhe i ka gati të gjitha praktikatat, sepse në të njëjtën mënyrë është vepruar edhe me projektligjet e tjera që janë miratuar duke kaluar në këtë komision, por edhe në parlament.

Besnik Baraj - Thjesht për të marrë eksperiencën tuaj, ekzistojnë licenca të ngjashme për vlerësimin e ndikimit në mjedis, a mendoni se në mënyrë analoge do të jetë pozitive shtrirja e kësaj eksperience edhe në atë sektor, sepse rezultojnë që një pjesë e mirë e tyre e kanë marrë në forma jo shumë profesionale, që nuk kanë *background-in* e duhur? Shpesh kemi pasur nga subjekte të ndryshme ankesa në lidhje me abuzimin nga ana e tyre në vlerësimet e ndryshme. Ky lloj certifikimi, a mendoni se do të jetë pozitiv edhe në atë sektor?

Mehmet Hasalami – Mendoj se duhet të jetë i aplikueshëm në çdo sektor, jo vetëm në mjedis. Ne e kemi bërë thjesht për të shkurtuar burokracinë dhe nuk i kemi toleruar kërkesat teknike. Kërkesat teknike për t’u certifikuar mbeten po ato: duhet të kesh diplomën, eksperiencën, të jesh i kualifikuar në një profesion të ngushtë që të jesh kompetent për këtë. Procedura e vjetër, që shkojë më përpara në QKB, filloje që të aplikojë për licencë, pastaj duhet të mblidhë Komisioni i Derregulimit për verifikimin e të gjithë dokumentacionit, nga një procedurë shumë e gjatë, tashmë thjeshtohet. Janë po të njëjtat kategori punonjësish që përfitojnë nga kjo lehtësi.

Ilir Bejtja - Kam për të shtuar diçka, dua t'ju vë në dijeni dhe të theksoj se të gjitha projekteve zhvillimore në sektorin e industrisë minerale ku përfshihet gjeologjia, miniera, fabrika e pasurimit, metalurgjia e të tjera, iu bashkëngjitet ose është i detyrueshëm dhe studimi mjedisor, i cili bëhet me ekspertë, të cilët vlerësohen ose licencohen nga Ministria e Mjedisit. Të gjitha procedurat për vlerësimin mjedisor të këtyre projekteve zhvillimore, i ndjek Ministria e Mjedisit. Pra, janë të ndara projektet zhvillimore të fushës sonë. Me këtë projektligj ne nuk licencojmë asnjë autoritet qoftë fizik, qoftë juridik për vlerësimet mjedisore. Mund të ketë inxhinierë që kanë plotësuar kushtet, si gjeologë miniere e të tjerë që licencohen te Ministria e Mjedisit. Këto shkojnë në harmoni njëra me tjetrën. Shqetësimi që ngrihet tani për pjesën e mjedisit nuk mund ta thjeshtojmë, sepse...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, certifikohen.

Mehmet Hasalami - Në lidhje me pyetjen e zotit Gjuzi theksojmë se heqja e licencave për 23 modele nuk është pjesë ose atribut i këtij ligji, por në kuadrin e gjithëpërfshirjes duke filluar nga nafta, industria e të tjera, janë hequr disa nga licencat që janë menduar se nuk janë të nevojshme. Nuk është vetëm kjo, është fushë më e gjerë.

Ilir Bejtja – Për sa i përket shqetësimit për taksat, ato nuk lidhen me aspektin e licencimit.

Kujtim Gjuzi - Në përfundim të analizës, ndër të tjera u arrit në konkluzionin se 23 licenca eliminohen. Këto licenca, a mos janë objekt i korrupsionit, i presionit mbi këta biznesmenë? Po e bëj pyetjen e drejtpërdrejtë se u anashkalua. Ju lutem, më jepni një përgjigje!

Mehmet Hasalami - Mund t'ju jap një sqarim juridik, licenca në vetvete është një akt administrativ, i cili mundëson ushtrimin e aktivitetit. Në një farë kuptimi është një barrierë administrative. Teorikisht duke e hequr si licencë, sigurisht që minimizohen edhe efektet që thoni ju, pra në sensin se nuk ka nevojë për një akt administrativ shtesë që të ushtrosh aktivitetin, por mjafton që me certifikatën përkatëse të marrjes së programit, e ushtron menjëherë profesionin.

Ilir Bejtja - A mund të them një shembull? Në licencë ne kemi shërbime portuale, para 3 vjetëve ne kemi miratuar licencë për atë që vendos kapon e ankorimit. Ndërkohë që të gjitha shërbimet e omerxhimit kanë brenda edhe atë.

Kujtim Gjuzi - Më kuptoni se ku e kam thelbin e pyetjes sime? Këto 23 licenca që janë hequr, ishin dhënë më parë apo jo?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Një sekondë, që ta sqarojnë ekspertët!

Si një nga biznesmenët që nuk mund të jem më, sepse nuk më lejon ligji, jam i shqetësuar për një gjë: këto 23 licenca të hequra që thoni ju, kanë goditur 23 biznesmenë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

I nderuar koleg, a mund të ma sqarojnë ekspertët? Janë të qeverisë dhe unë e di se ti do t'i ndihmosh...

I nderuar koleg, nuk dua ta dëgjoj nga ju, ne jemi në kundërshtim, ne jemi opozita, ti je pozita. Ti do t'i mbrosh ata, unë do t'i sulmoj. Logjika është imja, ti nuk mund të më japësh tëndën.

Niko Peleshi - Ju lutem, përfaqësuesit e ministrisë, sqaroheni pak më mirë.

Kujtim Gjuzi - Zotërinj përfaqësues të ministrisë, ndoshta unë nuk e kuptoj mirë si ekonomist i biznesit, kam studiuar edhe të drejtën juridike për biznesin, a ka mundësi të ma sqaroni këtë pikën këtu?

Zoti kryetar pa sqaruar këtë pikë, të mos vazhdojmë.

Mehmet Hasalami – Nuk është hequr ndonjë licencë me emër: e Ilirit, juaja apo e dikujt tjetër, por është hequr një kategori licence. Kemi licencë për marangozë, kemi pasur licencë me vete për atë që ngul gozhda, për atë që sharron apo për të tjera më radhë. Këto elemente, që s'kishin edhe kuptim, ose në kuptimin e ligjit, janë burokraci të tepruara. Pra, do të thotë t'ia vështirësosh jetën biznesit, që për çdo element shtesë që i del atij në kuadrin e biznesit që bën, të vijë e të kërkojë përsëri licencë. Këto janë eliminuar, janë parë të pavlera. Është pikërisht ajo që ju thashë pak më parë. detajimi është bërë në mënyrë të tillë, sipas mendimit tonë, sepse thjesht bëhet llum nëse vjen kushdo e merr çdo lloj gjëje, nëse vijnë e përplasen gjashtëqind vetë në një lloj procesi, në një lloj pune, ndërkohë që është një profesion, një punë.

Kjo është ideja. Nuk është se i kemi hequr ndokujt në mënyrë specifike licencën për të punuar. Absolutisht jo. Në ligj dhe në vendimin e qeverisë është thjeshtuar lista e kategorive të licencave, të cilat duhet të jepen për arsye teknike, në lidhje me proceset që kryejnë personat apo individët.

Ju jap një shembull: në ndërtim, të paktën, me sa di unë, kemi rreth 22 NSS, rreth 14 NP. Janë edhe një pjesë tjetër licencash, të cilat lidhen me telekomunikacionin. Edhe ato, po të jetë e mundur të shihen me vëmendje, mund të thjeshtohen. Pse? Sepse bëhet gjithmonë shumë e vështirë, që një kompani, në rastin konkret, e cila mund të ketë mjaftueshëm volume

pune për të marrë pjesë në një tender, nuk e ka klasifikimin e duhur. Sepse, duke i ndarë në shumë licenca, edhe në elementë më të vegjël, si për shembull: punët civile të ndara, gërmim me ekskavator, gërmim me lopatë, por që në fund të fundit mbetet po gërmim, përfundojmë në atë pikë, kur secila prej tyre mbetet po në kategorinë e vogël A. Ato janë të shoqëruara edhe me volume pune, që ti të mund të ngrihesh në kategori, për shkak të eksperiencës.

Në këtë aspekt, ne do ta vazhdojmë këtë procesin e thjeshtimit, kur ka raste të tepruara burokratike, e që e bëjnë më të vështirë për bizneset pajisjen me licenca teknike, qoftë për drejtuesit e tyre teknike, qoftë edhe si kompani apo individë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kujtim Gjuzi – E fundit, zoti Kryetar!

Atëherë, me dashamirësinë më të madhe për të dhënë dakordësinë në këtë rast, sepse është votë që më pas komentohet edhe nga mbështetësit tanë jashtë, pro, kundër apo abstenim, unë do t'ju këshilloja, nëse e pranoni këshillën time, që pikërisht këtë pikë të mund ta sqaronit, me qëllim që unë të mos e bëja këtë debat e të mos ua merrja kohën kolegëve të mi.

Ju falënderoj!

Niko Peleshi – Fjalën e ka zoti Shtjefni. Më pas, zoti Pëllumbi.

Zef Shtjefni – Pak a shumë çështjet u trajtuan, zoti kryetar. Ne jemi të shqetësuar, jo për rastin konkret, se u sqaruan ca gjëra, por problemi ynë është tjetërkund: në shumë raste ka ndodhur, që ju si maxhorancë, bëni ligje për interesat tuaja. Prandaj dhe ne ju bëjmë pyetje këtu, sepse jemi të paqartë në lidhje me shumë ligje që ju bëni. Mendoj se diku do t'i dalë tymi edhe kësaj pune që po bëni ju. Prandaj po debatojmë këtu, ngaqë jemi të shqetësuar për faktin e kujt mund t'i hiqet licenca. Kush preket? Sa është numri i tyre? Prandaj dhe ne pyesim, e nuk bëjmë keq që pyesim në lidhje me këtë punë. Mbase kjo që po bëni ju është në të mirë, por duke mos e parë këtë projektligj, e duke mos e lexuar relacionin përkatës, e kam të paqartë: në qoftë se janë 30 licenca, e prej këtyre hiqen 20, duke mbetur 10, kjo do të thotë se është për mirë. Ama, në qoftë se ju po bëni një projektligj, që u leverdis personave të caktuar, me qëllim që ta kapni edhe këtë fushë minerare, atëherë do të jetë shumë keq. Kaq kisha.

Faleminderit!

Mehmet Hasalami – Nuk bëhet fjalë për heqje licencash. Bëhet fjalë për heqje të kërkesës për licencë. Pra, një projektues, një inxhinier që sot ka një diplomë, mund ta zhvillojë një projekt pa licencë, në raste të veçanta, kur nuk ka rëndësi të veçantë.

Pra, edhe një herë: hiqet kërkesa për licencë, kërkesa për t'u licencuar. Pra, janë një 400 licenca në gjithë QKB-në, siç e tha edhe zëvendësministri, që jepen për lloj-lloj punimesh. Ministria jonë i ka reduktuar në rreth 23 të tilla, që nuk kërkohet licencë për të projektuar, për të vazhduar, për të punuar. Pra, kuptojeni: nuk është heqje licence, por heqje e burokracive, heqje e kërkesës për t'u pajisur me licencë.

Me shumë të drejtë e tha zoti Gjuzi, se mbase edhe shprehja aty mund të ishte pak e diskutueshme, sepse kur thuhet: heqje licence, duket sikur u ke hequr licencat...

Niko Peleshi – Besoj se u sqarua kjo, të lutem!

Mehmet Hasalami – Absolutisht, keni shumë të drejtë!

Niko Peleshi – Zoti Pëllumbi.

Arben Pëllumbi – Faleminderit, Kryetar,

Faleminderit zëvendësministrit dhe përfaqësuesve të ministrisë, për shpjegimet që dhanë.

Unë do të doja ta vazhdoja aty ku e kemi nisur edhe me ligjet e tjera të deregulimit: diferenca midis licencimit dhe certifikimit, që ka të bëjë me numrin e dokumenteve që duhen paraqitur, për t'u pajisur me njërën ose me tjetrën. Licencimi, deri më sot, por besoj se edhe për licencat që do të ngelen, ka një numër shumë më të madh dokumentacionesh se sa certifikimi. Për këtë arsye, qeveria shqiptare ka ndërmarrë këtë nisëm, që në disa sektorë e në disa veprimtari, të cilat konsiderohen burokratiksht të fryra, të hiqet nevoja e licencimit, por sigurisht që certifikimi do të mbetet. Certifikimi është një procedurë, e cila kryhet në mënyrë shumë më të thjeshtë se licencimi.

Besoj se në këtë mënyrë ndihmohet biznesi, ulet korrupsioni dhe zvogëlohet koha për fillimin e një aktiviteti të caktuar. Këtu kam parasysh se pak më përpara kaluam edhe një propozim tuajin, një projektligj në fushën e energjisë, në fushën e licencimit e të certifikimit të ekspertëve për energjinë e rinovueshme. Kam përshtypjen se edhe ky ligj është po në këtë kuadër, por nga kjo që lexoj, shkojmë edhe pak më tutje: që në fushën e projekteve nuk do të kemi fare licencim, do të kemi vetëm certifikim. Certifikohet si personi fizik, ashtu edhe personi juridik, kur ky ka një person të certifikuar brenda organikës së vet. Pra, jemi dy hapa më tutje. E heqim fare konceptin e licencës në fushën e projekteve në sektorin minerar. Mjafton të jesh i certifikuar, procedura përcaktohet si është, dhe thjeshtimi bëhet akoma më i madh se në raste të tjera, kur të paktën personi fizik apo specialisti duhet të ketë qenë i certifikuar e i licencuar. Pastaj, një person i licencuar, brenda një kompanie juridike, me status juridik, mund të bënte edhe certifikimin e kompanisë së caktuar.

Pra, më vjen mirë që këtu jemi dy hapa më tutje, dhe shpresoj të vazhdojmë kështu, me qëllim që t'i thjeshtojmë sa më shumë procedurat burokratike, që besoj se i kemi pasur të tejkopura. Mendoj se kjo është një iniciativë mjaft e mirë e qeverisë.

Niko Peleshi – Zoti Marto.

Andrea Marto – Unë këmbëngul sërish, që në projektligj nuk del e qartë se cili është autoriteti që lëshon certifikatat. Këtu, te pika 3, që u citua, thuhet: “Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për minierat, miraton procedurën, kategoritë, kushtet, kërkesat e kualifikimit e të eksperiencës profesionale për personin, të cilit i lëshohet certifikata e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.”

Kush e jep këtë certifikatë? Ministri, Drejtori i Përgjithshëm, ndonjë autoritet tjetër i pavarur? Kush e jep këtë certifikatë? Këtu thuhet vetëm që përcaktohen kushtet, që një person i caktuar fizik të gëzojë të drejtën për t'u certifikuar, por kush e certifikon? E nënkuptohet se është ministri?

Mehmet Hasalami – Në qoftë se e keni parasysh, edhe te ligjet e tjera që kemi kaluar, propozuar nga e njëjta ministri, e kemi bërë këtë debat, dhe është lënë që në VKM-në përkatëse do të dalë edhe se cili do të jetë enti që do të japë certifikimin. Mund të jetë ministri, mund të jetë drejtori, kjo do ta varet nga përcaktimet që do bëjë VKM-ja.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ilir Bejtja – Jo detyrimisht të gjithë ligjet do të kenë të njëjtën skemë. Ne po themi se Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit do të miratojë procedurat. Në procedura do të qartësohet. Mund të jetë Sekretari i Përgjithshëm, mund të jetë Drejtori i Përgjithshëm, mund të jetë zëvendësministri, AKBN-ja, ministri. Varet nga lloji i licencës teknike. Nuk e di, ndoshta mund të jetë një komision.

Elementi tjetër që doja t'ju përmendja, sa për t'ju sqaruar diçka. Thjeshtimet do të vazhdojnë deri sa të arrijmë ndryshimet e fundit, të bëra në prill të vitit 2019, që në Bashkimin Europian është hequr totalisht koncepti i licencës dhe i drejtorit teknik. Pra, atje ka një kompani, që është e licencuar dhe me ekspertizë në punimet e një kategorie, e cila për çdo lloj gare, për çdo lloj punimi, është e detyruar që në projektin e saj të ketë stafin e certifikuar përkatës, me njohuritë e nevojshme për të realizuar projektin. Pra, nëse ka për komunikacionin, nuk është e detyrimisht e nevojshme ta ketë atë full time për gjithë jetën, si profesion.

Sot ne e kemi problem këtë. Të gjithë kompanitë në një fushë të caktuar, duhet të kenë dhjetë, pesëmbëdhjetë, njëzet licenca, që duhet t'i garantojnë me shumë diploma, të cilat

shpeshherë në treg nuk ekzistojnë. Kemi edhe problemin e përplasjes së një drejtuesi teknik në dy a tri kompani.

Pra, kjo është ideja: me certifikimin, ne i japim mundësi kompanive që të jenë më fleksibël e më aplikues.

Besnik Baraj – Ilir, të them të drejtën, unë bashkohem me shqetësimin e Andreas. Quhet licencë apo quhet certifikatë, pavarësisht kësaj, ajo prapë është një barrierë. Pra, dikush do ta bëjë këtë certifikimin. Për sa kohë që ju nuk e pasqyroni në ligj këtu, që për mua duhet të jetë, sepse ju ecni dy-tre hapa përpara si institucion përgjegjës, në raport me atë VKM-në që do të dalë. Normalisht, për ju duhej të ishte e qartë që tani, se kush do ta bëjë këtë lloj certifikimi. Në këtë rast, unë shikoj prapë premiset e mundësive për të komplikuar historinë, e për të pasur pastaj, jo nga ju sigurisht, tendenca për të abuzuar.

Mehmet Hasalami – Vendimi i qeverisë i ka të përcaktuara edhe komisionin, me përfaqësues nga universiteti, Fakulteti Gjeologji-Miniera, AKBN-ja, AKSEM-i dhe institucionet e tjera. Pra, është përfshirë edhe stafi akademik Pra, absolutisht, ne jemi vetëm duke e lehtësuar procedurat. Ky komision do të përcaktohet po me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për Industrinë Minerare.

Pra, ka nga të gjitha fushat: universiteti, AKBN-ja, Shoqata e Minierave, Drejtoria e Minierave, si dhe specialistë të tjerë të zgjedhur të kësaj fushe.

Ky komision kontrollon të gjitha kërkesat që ka përcaktuar...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, bën certifikimin, njeh aftësitë teknike, kontrollon çfarë dokumentesh ka sjellë X person, X inxhinier, dhe automatikisht e licencon.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më falni, nëse mund ta sqaroj! Ky komision, i cili funksionon sot në ministri, pra, që përcaktohet sipas rregullave e procedurave të Këshillit të Ministrave, që është në fuqi aktualisht, përsëri certifikimin bën. Aktualisht kishim një barrë të tepërt administrative, sepse personi apo subjekti, pasi merrte certifikatën nga ky komision, ku dëshmohej se ai ka ekspertizën, profesionalizmin, shkonte më pas në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe aplikonte sërish për të marrë një licencë. Duke qenë se Qendra Kombëtare e Biznesit nuk kishte arsye të përfshihej këtu, sepse nuk jep një imput shtesë në proces, se do të vijë përsëri në ministri, u vlerësua që të hiqej.

Niko Peleshi – Qartë! Ka pasur certifikatë dhe licencë, ndërsa tashti ngelet vetëm certifikata.

Mehmet Hasalami – Po, dhe që do të jepet përsëri nga ky komision.

Niko Peleshi – Pra, kemi vetëm një thjeshtim burokracie. Nuk shkon në QKB për të marrë licencën. Thjeshtim burokracie. Thjeshtimi i burokracisë synon pikërisht të kundërtën e dyshimit që ju keni këtu: pra, për korrupsion dhe ryshfet. Sa më pak burokraci të ketë, aq më pak hapësira ka për ryshfet. Ky është qëllimi i deregulimit, apo jo?

Ilir Bejtja – Madje ka mjaft raste kur ne kemi pasur shqetësime, për shkak të dendurisë së aplikimeve, na kalojnë në heshtje, me miratim në heshtje. Një muaj i mban QKB-ja, vonohen përsëri deri sa të vijë tek ne për miratim, është burokraci e gjatë. Në këtë mënyrë e mbarojmë shpejt.

Niko Peleshi – Zoti Muaj. Më pas zoti Nasufi.

Nimet Musaj – Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë, duke parë diskutimin dhe vlerësimin që iu bë kësaj projektrezolute, shpreh vlerësimin se shqetësimet tuaja dhe tonat, duhen marrë bashkërisht në konsideratë, që sa të kemi mundësi të shmangim atë që kriza në biznes.: korrupsionin. Duke e parë dhe duke i hedhur një sy materialit, që po mundohem ta lexoj edhe një herë, thuhet: afati i vlefshmërisë së licencës, të autorizimit dhe lejes, procedurat e shqyrtimit e të vendimmarrjes, afatet për kryerjen e tyre, si dhe procedurat e revokimit, miratohen me akte nënligjore, në zbatim të ligjit që e parashikon atë licencë, autorizimin pa leje.

Të mos vijmë në atë pikën që, ky komision e heq kur të dojë këtë licencë ose këtë leje, duke ia revokuar kur të ndonjë ai, sepse në këtë mes ka patjetër korrupsion. Sepse, është në dorën e tyre ta japin ose ta heqin këtë licencë. A ka afate kohore? Çfarë eksperiencash keni ju, gjatë kësaj periudhe që punoni? Si mund ta zgjidhim më mirë këtë çështje, që ata biznesmenë të nderuar, që punojnë, ta ndjejnë veten të qetë e normalë, dhe këtë korrupsion, që normalisht ekziston, ta shmangim sa të kemi mundësi?

Ju faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Zoti Nasufi.

Ilir Bejtja – Zoti kryetar...

Niko Peleshi – Dëgjojini të dyja pyetjet, dhe përgjigjuni më pas.

Ilir Bejtja – Por, po flasim për korrupsion tashti, kur...

Niko Peleshi – Të lutem, është e drejta e gjithsecilit, që të ngrejë shqetësime. Dëgjoni edhe zotin Nasufi, dhe përgjigjuni pyetjeve me radhë.

Fadil Nasufi – Në lidhje me...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Zoti Bejtja, ju lutem, flisni kur t'ju japim fjalën. Ju lutem, se jeni të ftuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Bejtja, ju lutem, se jeni i ftuar këtu! Ju lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Bejtja, ju lutem, mos e përsërisni këtë, sepse jeni i ftuar dhe do të flisni vetëm kur t'ju japim fjalën! Deputetët kanë të drejtë të shprehin mendimet e tyre ashtu siç e mendojnë.

Urdhëro!

Nimet Musaj – Zoti Zëvendësministër, e para, emocionet t'i lemë për në punë, ngarkesën që kemi ta lëmë për atje ku është. Ne kemi bërë maksimumin t'ju respektojmë, t'ju dëgjojmë dhe t'ju mbështesim sa herë që na keni sjellë projektligje, si dhe të vëmë në jetë ato që janë më të mirat për vendin. Shpresoj të na mirëkuptoni dhe ta tërhiqni këtë lloj sjelljeje që bëtë ndaj deputetit përkatës. E para, nuk ke votuar deputetin, por ke votuar partitë: ose partinë Socialiste ose Partinë Demokratike. Ne s'kemi dalë të na japësh votën me kryq, për shkak të këtij ligji zgjedhor që kemi. Kështu që, të lutem, le të mos i kalojmë pjesët, ose do të detyrohemi të largohemi ne, dhe ta vazhdoni ju mbledhjen.

Niko Peleshi – Zoti Nasufi.

Fadil Nasufi – Duke kërkuar edhe mirëkuptimin për këtë ndërhyrje, besoj se edhe ju deputetët e opozitës shprehët një lloj shqetësimi në lidhje me praktikën e mbartura në ushtrimin e aktiviteteve në fushën minerare e të tjera, apo dhe të gjitha sikletet që mund të ketë biznesi, barrierat administrative apo klimën në përgjithësi, unë kam këtë prononcim: projektligji i paraqitur, me komentet që u bënë nga kolegët deputetë, është i mirë dhe bën një reflektim nga të të gjitha praktikave të trashëguara. Në thelb ka mbylljen e këtyre barrierave, lehtësimin e procedurave, si dhe shmangien e një lloj dualiteti. Këtu e kam më shumë merakun. Artikulimet e secilit këtu po rrahin. Po marr praktikën e gurore në malet e Tomorrit. Ministria e Mjedisit ka konflikt me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjetikës. Në bazë të letrave të lëshuara, është në krah të biznesit, po për sa i përket dëmit mjedisor, Ministria e Mjedisit konstaton një masakër të vërtetë e barbare. Nuk kam lidhje me temën që kemi sot, por në këtë decentralizim që kemi ne, duhet një autoritet, që edhe biznesi të mos trokasë derë më derë për licenca apo tek autoriteti i qendrës së biznesit, por të jenë të kalkuluara. E gjithë trupa shtetërore, institucionet përkatëse, që kanë impakt në mjedis, që kanë impakt në fushën e shfrytëzimit të pasurive nëntokësore, të bëjnë ç'është e mundur për

të eliminuar gjithë këtë trashëgimi negative që kemi, për t'i vënë në standardet bashkëkohore të ligjeve e të bashkëveprimit ndërinstitucional.

Ky është merakuri që kam.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Po, zoti Bejtja.

Ilir Bejtja – Së pari, ju kërkoj ndjesë për tonin, por marr shkas nga fjala korrupsion. Është bërë si batutë, po për mua nuk është batutë. As për kolegët e mi që punojnë në ministri nuk është batutë. Nëse ka një rast të tillë, tregojeni me gisht: filani ka bërë korrupsion. Pastaj mund ta shikoni nëse reagojmë apo nuk reagojmë. Jemi në shërbim të njerëzve çdo ditë, kalojmë me qindra e mijëra raste, e jo nga dy e nga tre. Nga çdo njëmijë që aplikojnë, ne nxjerrim dy apo tre licenca në ditë. Kemi tre ose katër komisione vlerësimi në muaj. Kalojmë nga të gjitha llojet e licencave. Rastet e ankesave janë minimale, dhe nëse janë minimale, kjo lidhet më shumë me moskuptimin e ligjit. Komisioni nuk është i përbërë vetëm nga ministria. Ministria s'ka as gjysmën e komisionit, sepse ai përbëhet nga shumë institucione të tjera. Këto i thashë për t'ju sqaruar se, edhe në përpjekjen që po bëjmë, arsyeja kryesore është të ulim burokracinë dhe hapat e licencimit. Nëse ulim burokracinë, nuk e shtojmë korrupsionin. Mbase për ju është normale të thoni gjithë ditën se ka korrupsion apo se ky është i korruptuar, po për mua është direkte, sepse jam personi në sallë. Nëse ka raste të tillë, tregojini me gisht.

Pra, unë nuk mund ta pranoj të thuhet në ajër që ka korrupsion.

Niko Peleshi – Dakord! Të lutem tani, sepse e drejta e deputetit nuk mund të jepet apo të hiqet nga ju. Ju lutem, jeni këtu i ftuar.

Ilir Bejtja – Nuk desha të konfliktohesha me njeri e asgjë prej gjëje.

Niko Peleshi – Secili prej deputetëve ka të drejtë ta shikojë edhe me sensin kritik apo opozitar.

Ilir Bejtja – Është akuzë, kryetar, prandaj po ju thosha.

Niko Peleshi – Jo, nuk është akuzë. Është një e drejtë e deputetëve për të bërë propozime, qoftë edhe kritike apo opozitare, s'kemi çfarë të bëjmë. Ju keni të drejtë që, në qoftë se vihet gishti, duhet të shkohet në vend tjetër, jo këtu, por nuk besoj se pati ndonjë akuzë personale, për ligjin u sqaruan deputetët. Është e vërtetë ajo që thatë ju, që një ligj që propozon deregulim nuk mund të jetë një ligj që krijon hapësira për ryshfete. E kundërta e kësaj është e vërtetë, sepse, kur shtohen hallkat, kur shtohen licenca dhe kur shtohen zyra, ku duhet të trokasësh, potencialisht krijohet mundësia për ryshfet. E gjithë reforma e qeverisë shqiptare për deregulimin synon ta luftojë korrupsionin jo me fjalë, jo duke luftuar pasojat

dhe duke dënuar përmes një sistemi të ri drejtësie të gjithë ata që kapen dhe bien në rrjetën e drejtësisë, por edhe duke modernizuar proceset dhe duke reduktuar burokracinë. Pra, në dy drejtime të ndryshme, sepse është e pamundur të luftohet korrupsioni vetëm duke rritur forcën e ligjit dhe për pasojat e tij, pra për të gjithë ata që kapen, por duhet të mbyllim shtigjet, dyert dhe dritaret nga ku burokracia lejon të futet ryshfeti dhe fenomene të tjera negative. Kjo nuk ka diskutim dhe bie dakord me përfaqësuesit e ministrisë, por ju lutem mos e merrni personale, sepse çdo deputet ka të drejtë të hamendësojë për sa kohë që s'ka treguar dikë me gisht.

Zoti Musaj, sa më shkurt dhe më pas kalojmë në votim.

Nimet Musaj- Faleminderit!

Zoti Bejtja, mendoj se ju dhashë një argument normal për të mos ju akuzuar. Nëse do të kisha diçka me ju personalisht, mund t'ju thosha, por nuk ishte ky qëllimi im. Qëllimi im ishin afatet kohore për të shmangur këtë të ashtuquajturin korrupsion. Nuk kam asnjë lloj informacioni në këtë drejtim për t'i bërë mirë kësaj fraze këtu për afatin kohor që ju ta ndieni veten mirë.

Ju faleminderit!

Niko Peleshi- Zoti Marto.

Andrea Marto- Faleminderit, zoti kryetar!

Para se të kalojmë në votim, edhe më propozimin e këshilltarëve të komisionit, propozojmë që neni 3 të ndryshohet dhe të jetë si vijon...

Niko Peleshi- Do ta bëjmë kur të shkojmë te nenet, zoti Marto.

Përpara se të kalojmë në votim kemi një letër, një shkresë nga Shoqata e Minierave të Shqipërisë, zoti Adhurim Çausi, presidenti i shoqatës. Besoj se është në sallë zotëria...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

S'ka problem. Dua një prezantim shkurt se cili është thelbi i ndryshimit që ju propozoni dhe më pas do të dëgjojmë ministrinë dhe relatorin se çfarë opinionit kanë për këtë propozim dhe e diskutojmë gjatë diskutimit nen për nen. Urdhëroni!

Adhurim Çausi- Unë jam Adhurim Çausi, inxhinier miniere, me një eksperiencë 45-vjeçare. Aktualisht jam president i shoqatës, pasi para pak kohësh ish-presidenti ndërroi jetë.

Unë e njoh ligjin minerar në përgjithësi, edhe si specialist, e kemi diskutuar dhe me pjesëtarë të tjerë të stafit të shoqatës, edhe me anëtarë të veçantë, pasi koha ka qenë e shkurtër dhe mundësitë për të komunikuar me të gjithë i kemi pasur minimale.

Ideja është kjo: në ligjin mineral nr. 10504 të vitit 2010, datë 15.07.2010 dhe në ndryshimet e bëra në vitin 2014, në nenin 44, pika 1, thuhet kështu: “Lejet minerare të dhëna, sipas ligjit mineral, janë të patransferueshme”, ndërkohë që të gjitha lejet e dhëna përpara këtij viti janë të transferueshme nga një subjekt tek tjetri. Ky përkufizim ose ky përcaktim në logjikën tonë ka pasur parasysh faktin që mund të ketë abuzime me mungesën e transferimit. Unë kam qenë shëf i sektorit të mbikëqyrjes së aktiviteteve minerare në AKBN dhe e njoh mirë sektorin mineral. Unë jam administrator i një subjekti të caktuar. Në një moment të caktuar ndodh aksident dhe vdes dhe familja ime nuk e trashëgon, nuk ka mundësi fizike apo financiare për ta ndjekur më tej këtë. Në këto kushte janë bërë investime për një periudhë kohe të caktuar dhe ky aktivitet tani duhet të mbyllet dhe i kalon ministrisë, e cila, nga ana e saj, duhet të ndjekë procedurat e ligjit. Nëse një subjekt ka një leje minerare ose disa leje dhe për njërin nga këto nuk ka treg, por ka bërë disa investime, atëherë mund të lejohet transferimi i lejes nga dhurimi te dikush tjetër, nga një subjekt te një tjetër, sepse në ligjin mineral çdo subjekt që pajiset me leje minerare në bazë të *case flow*, që është bërë, paguan garancinë e investimeve, e cila është në disa dhjetëra milionë lekë të vjetra. Pra, nëse subjekti që ka një leje minerare ka bërë investime për një periudhë 1-2-3-4 apo 5-vjeçare, për xarsye, nuk mund ta ndjekë këtë aktivitet, atëherë, kjo do të transferohet te një subjekt tjetër, i cili ka garancinë financiare dhe juridike për të bërë një gjë të tillë.

Faleminderit!

Mehmet Hasalami - Deri tani, me ligjin aktual, transferohen vetëm lejet minerare që janë dhënë para vitit 2008, që do të thotë se janë dhënë pa procedurë konkurruese, kurse të gjitha lejet e tjera të dhëna me procedurë konkurruese nuk transferohen. Në fakt, besoj se tani lind domosdoshmëria që pas një periudhe 5-6 vjeçare, kur subjekti që ka fituar të drejtën e përdorimit të asaj zone minerare ka plotësuar kushtet, ka paguar garancitë e investimit dhe ka zhvilluar projektin, por për një pamundësi e tij, për ndryshime të stafit teknik e të tjerë, ne mendojmë që kjo leje t’i transferohet, natyrisht kundrejt kushteve e kritereve që përcaktohen ekzaktësisht, si ai që e

Niko Peleshi- A jeni dakord me propozimin e shoqatës?

Mehmet Hasalami - Ne jemi dakord.

Niko Peleshi - A e keni pasur këtë propozim qëkur e çuat në qeveri për vendim?

Mehmet Hasalami - Jo.

Niko Peleshi - Ka ardhur më pas?

Mehmet Hasalami – Po.

Niko Peleshi - Zoti Marto, fjala për ju.

Andrea Marto- Duke e gjykuar që shqetësimi i shoqatës është i drejtë, mendoj se ne duhet ta shqyrtojmë, por si komision nuk jemi gati sot, sepse nuk kemi pozicionimin e argumentuar të ministrisë dhe të qeverisë. Prandaj, ose do ta kalojmë këtë ligj siç e kemi, vetëm për deregulimin, dhe do të vijë një herë tjetër shtesa, ose ta shtyjme këtë e të bëjmë një mbledhje tjetër dhe t'i bëjmë bashkë.

Niko Peleshi - Unë mendoj që ky propozim i shoqatës, siç edhe folëm pak në konsultën para mbledhjes, është përmbajtësor, pra është ndryshim në përmbajtje dhe lidhet me ndonjë korrektim apo plotësim të thelbit të këtij projektligji. Ne kemi një ndryshim në kuadrin e deregulimit për heqjen e disa licencave, ndërkohë kjo është një gjë tjetër, nuk mund ta quajmë një deregulim. Pra, ndryshon edhe frymën e këtij projektligji. Kështu që nuk besoj se na lind, moralisht të paktën, e drejta që ta propozojmë apo ta miratojmë, duke e anashkaluar diskutimin më parë në qeveri. Nuk e di çfarë mendimi keni ju, sepse çdo propozim do të hidhet në votë, por propozimi im është që në të ecim me projektligjin siç e kemi. Shoqatën e inkurajojmë ta paraqesë në ministri, ministria në qeveri dhe le ta fusin në procedurë normale për ta ndryshuar, në qoftë se çmohet e arsyeshme. Ne nuk mund ta bëjmë këtë ndryshim tani, sepse nuk ka lidhje me frymën dhe me thelbin e këtij projektligji, që është një masë deregulimi. Kjo është një gjë tjetër. Ligji minerar mund të ketë shumë nevojë për rregullime dhe përmirësime të tjera, por s'mund ta marrim në këtë rol tani, duke anashkaluar hallkën e qeverisë dhe të ministrisë. Ky është propozimi im, gjithsesi ju e dini.

Besnik Baraj - Kjo që thoni ju është e drejtë nëse ndryshimi që kërkohet nuk pasqyrohet këtu, por, nëse ekziston mundësia të pasqyrohet në ndonjë nen të veçantë, atëherë...

Mehmet Hasalami - S'ka lidhje...

Besnik Baraj - Në qoftë se s'ka lidhje, atëherë ashtu... Shqetësimi im është se mos vallë ky lloj propozimi, i cili është i drejtë, kalon dhe vështirësohet shumë për t'u pasqyruar nga ana e ministrisë dhe vendimit të Këshillit të Ministrave.

Niko Peleshi - Natyrisht që mund të pasqyrohet në nen, më korrigjoni në qoftë se jam gabim. Me sa shikoj unë, në nenin 41 thuhet që lejet minerare, sipas procedurave konkurruese, janë të transferueshme vetëm pas një periudhe 10-vjeçare dhe shoqata propozon të bëhet 5-vjeçare. Ky është ndryshimi. Pra, teknikisht...

Mehmet Hasalami - Nuk transferohen fare...

Niko Peleshi- Po kjo 10-vjeçare?

Mehmet Hasalami - Jo 10-vjeçare, por 5-vjeçare.

Niko Peleshi- Si është neni ekzistues?

Mehmet Hasalami - Neni ekzistues thotë: “Lejet minerare të dhëna sipas procedurave konkurruese...”

Niko Peleshi- Cili nen është ky?

Mehmet Hasalami - Neni 41, pika 1, “Lejet minerare të dhëna sipas procedurave konkurruese dhe ato për të cilat është përfunduar një marrëveshje lehtësuese nuk janë të transferueshme”

Niko Peleshi- Ju propozoni ta bëjmë të transferueshme pas pesë vjetësh.

Mehmet Hasalami - Me logjikë dhe me gjithë eksperiencën në themi që edhe këta duhet të transferohen, pasi ka kaluar një periudhë 5-vjeçare.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Nuk mund ta bëjmë me një propozim të thjeshtë. Në qoftë se do të duhet të prekim ligjin, duhet marrë një nismë tjetër nga ne, nga një deputet ose nga një grup deputetësh për t’i bërë ndryshime ligjit minerar. Nuk mund t’i bëjmë ndryshim...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ose të vijë nëpërmjet rrugës që ka ardhur edhe ky ndryshim, i cili vjen nga qeveria këtu dhe hyn në procedurë. Ky është një ndryshim që nuk ka lidhje me thelbin e projektligjit që kemi në diskutim. Pra, nuk është një masë deregulimi, ku mund të thuhet se janë 23 licenca dhe të bëhen 24. Kjo është një gjë tjetër dhe është jashtë frymës së këtij projektligji. Nuk jemi kundër, sepse mund të jetë e drejtë dhe mund të ketë shumë nevojë edhe për shumë ndryshime të tjera, por nuk është ky momenti.

Arben Pëllumbi- Kryetar, faleminderit!

Ne e kemi të qartë procedurën dhe eksperiencën në këtë komision, por edhe në Kuvend. Të drejtën për të ndryshuar e kanë ose Këshilli i Ministrave, ose një deputet, ose 30 e ca mijë zgjedhës. Çfarëdo ndryshimi ligjor që kërkohet, qoftë edhe një fjali, ajo duhet të vijë nëpërmjet këtyre formave, nuk mund të vijë dot ndryshe dhe nuk e bëjmë në këtu. Iniciativa e marrë nga një deputet ka rrugën sesi depozitohet dhe sesi vjen në komision. Kështu që, në qoftë se bëhet fjalë për të ndryshuar pikat e këtyre neneve që kemi këtu apo për të ndërhyrë brenda këtyre që kemi, neve na lind e drejta ta bëjmë në komision, por ne nuk mund të shtojmë. Duke qenë dakord me atë që thonë, besoj se asnjë nga kolegët tanë nuk është kundër asaj, që ne jemi këtu vetëm për procedurën. Procedura sesi vjen një ligj në

komision dhe shkon në seancë për ndryshim është e mirëpërcaktuar dhe nuk e bëjmë dot ne këtu.

Besnik Baraj- Më falni në qoftë se jam gabim në propozimin tim, sepse nuk i njoh shumë mirë procedurat, por, duke pasur shqetësimin që ky lloj propozimi mund të marrë shumë kohë për t'u realizuar, muaj ose vite, dua t'u bëj një pyetje përfaqësuesve të ministrisë. A ekziston mundësia që ne ta shtyjmë për javën tjetër këtë ligj dhe ju të vini me një propozim, ku të përfshihet propozimi i arsyeshëm, që e pranoni edhe ju vetë, meqenëse flasim për një amendim, dhe të pasqyrohet? A ka ndonjë problem për ju? Pastaj zgjidhim edhe shqetësimin që ngriti Arbeni.

Niko Peleshi – Po, zoti Bejtja.

Ilir Bejtja- Nga ana administrative nuk funksionon kështu, pasi ky si ligj ka kaluar në qeveri. Absolutisht që ne mendojmë pozitivisht për ndryshimin e propozuar, por mund të duhet më shumë se sa një fjali. Kur ne themi: “Procedura konkurruese”, kemi parasysh që personi, i cili sot e ka të pamundur të vazhdojë lejen, ka fituar kundër një tjetri, i cili mund të ishte shpallur fitues me idenë që unë do ta mbaj 5 vjet dhe do ta lë. Këtu bëhet fjalë për grafikët e investimeve, për planin e prodhimit e të tjera me radhë, të cilat janë tregues për të qenë fitues, ku ti ndoshta ke paraqitur një plan shumë më agresiv dhe pas pesë vjetësh thua: “Unë nuk mund ta bëj”. Pra duhet parë edhe nga ana teknike. Ne nuk jemi kundër, por duhet parë me më kujdes.

Niko Peleshi- Atëherë, kemi dy opsione: ose ta votojmë siç e kemi sot, ose, në qoftë se ju mendoni se deri javën tjetër mund ta sillni nga qeveria amendimin e draftit, i cili vjen sot në shqyrtim, atëherë jemi dakord, por, në qoftë se nuk ka kohë fizike, e kalojmë edhe këtë ndryshim bashkë me ndryshimet e tjera që kenë, bëni një paketë tjetër ndryshimesh, çojini në qeveri dhe na i sillni, sepse ne jemi shumë të gatshëm t'i shqyrtojmë në kohë.

Ilir Bejtja – Përfitoj nga rasti që zoti Gjuzi erdhi në sallë e t'i kërkoj ndjesë!

Gjithsesi, ne do të sjellim edhe ndryshime të tjera, të cilat do të marrin 2 ose 3 javë kohë, por duhet të kini parasysh që shkojnë për opinion në ministri, shihen efektet e të gjitha me radhë. Prandaj, unë mendoj ta kalojmë kështu siç e kemi dhe pjesën tjetër patjetër që do ta marrim në konsideratë.

Niko Peleshi- Zoti Gjuzi, fjala për ju.

Kujtim Gjuzi- Së pari, zoti Zëvendësministër, unë jam nga ata burra të këtij shteti që nuk dua të më thotë askush më fal dhe faleminderit, sepse ne të gjithë bashkë kemi detyrim që të ecim përpara, ta ruajmë shtetin tonë, ju, qeveritarët, t'ju mbajmë nën kujdestarinë,

kontrollin dhe këshillimin tonë, sikurse ju të na sillni të gjithë ato që mendoni si ekspertë dhe specialistë. Mendoj se nuk kam asgjë që të të fal, sepse as nuk më vrave dhe as nuk më preve.

Faleminderit!

Niko Peleshi- Shumë mirë, e mbyllim me këtë gjest qytetarie të zotit Gjuzi dhe zotit Bejtja.

E hedhim në votimi në parim.

Kush është dakord në parim me projektligjin “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10304, datë 15.07.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar? Kundër? Një kundër. Abstenim? Një abstenim.

Miratohet.

Kalojmë në votimin nen për nen.

Kush është dakord me nenin 1, sipas variantit të Këshillit të Ministrave? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 2? Kundër? Abstenim? 1 abstenim.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 3?

Andrea Marto- Ne propozojmë që neni 3 të jetë si vijon: “Licencat aktuale për kryerjen e veprimeve studimore projektuese të lëshuara përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji ruajnë vlefshmërinë e tyre deri në përfundimin e afatit për të cilin janë lëshuar”. Ne mendojmë se ky është formulimi më i mirë.

Niko Peleshi- Atëherë, hedhim në votim propozimin e zotit Marto.

Kush është dakord me riformulimin e nenit 3, sipas propozimit të zotit Marto? Kundër? Abstenim? 2 abstenim.

Miratohet

Neni 4, “ Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare”. Kush është dakord? Kundër? Abstenim? 1 abstenim.

Miratohet.

Hedhim në votim në tërësi projektligjin “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10304, datë 15.07.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”. Kush është dakord? Kundër? 1 kundër. Abstenim? 1 abstenim.

Miratohet.

Faleminderit!

Për mbledhjen tjetër do të njoftoheni.

MBYLLET MBLEDHJA